



Pranuar / Dorezuar Priljenj/Pridato Received/Delivery	22.09.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPENSKICK	6202/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1120/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar., me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1120/2023 të datës 28.08.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë rr. "Dardania 1" nr. 93 Gjilan, kundër organit të punësimit, Inspektorati i Punës në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.1120/2023 e datës 28.08.2023, e parashtruar nga ankuesja .

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Inspektore e Punës" në Divizionin për Koordinim të Punës në Rajonin e Gjilanit, sipas Akt Emërimit me nr. 90/2017 të datës 30.11.2017, më datë 28.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5826/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Njoftimit me nr. protokoll: 150/2023 të datës 19.07.2023 që konfirmon kandidatin fitues të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës (tutje IP).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek IP, ndërsa Këshilli më datë 05.09.2023, me numër protokoll 1120/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga IP, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 5826/2023 të datës 28.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresë me nr.158/2023 e datës 31.07.2023 nga NJBNJ ne IP; Konkurs për lëvizje brenda kategorisë me nr. Reference RN00011780 i datës 05.06.2023; Njoftim për kandidatin fitues me nr.prot: 150/2023 nga NJBNJ e IP-së; Parashtrësë për ndërhyrje në procedurë me nr.prot.1816 e datës 24.07.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.08.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 1120/2023 i datës 05.09.2023; Akt Emërim i M.K. me referencë 90/2017 i datës 30.11.2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën "Inspektore e Punës" në Divizionin për Koordinim te Punës ne Rajonin e Gjilanit, sipas Akt Emërimit me nr. 90/2017 të datës 30.11.2017,ndërsa më datë 28.08.2023 në cilësinë e palës së interesit/ndërhyrësit në procedurë ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5826/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në lidhje më konkursin e datës 05.06.2023 me numër reference RN00011780,duke pretenduar se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket implementimit të rezultatit përfundimtar bazuar në këtë konkurs.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës përkatësisht vendimmarrjes në lidhje me këtë çështje ju referua dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, në të cilat dispozita parashihet se: "3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranimit në shërbimin civil". Poashtu kolegji me rastin e vendimmarrjes ju referua edhe dispozitave të nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim", dhe referuar bazës ligjore si më lartë konstaton faktin se ankuesja ankesën në Këshill e parashtron kundër njoftimit në lidhje me kandidatin fitues sa i përket konkursit me numër të referencës RN00011780 të datës 05.06.2023 që kishte të bënte me lëvizje brenda kategorisë ,lidhur me pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal në Gjilan", përkundër që ankuesja nuk kishte pozitë të nivelit të njëjtë me pozitën e shpallur sipas Akt Emërimit me nr. 90/2017 të datës 30.11.2017 dhe poashtu nuk kishte qenë kandidate pjesëmarrëse në këtë procedurë të rekrutimit, ndërsa kolegji sa i përket kësaj çështje u bazua edhe në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik respektivisht nenin 38 paragrafi 1 dhe 2 si dhe Rregulloren (QRK)nr.16/2020 për pranimitin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 40 paragrafi 1,2 dhe 3,me që rast referuar bazës ligjore të potencuar si më lartë ankuesja nuk ka pasur të drejtë të aplikojë për këtë pozitë nga se nuk ka qenë në kategori të

njëjtë me pozitën që është shpallur gjithnjë referuar akt emërimit të ankueses që është dokumenti bazë i krijimit të marrëdhënies së punës, dhe me qenë se sipas fuqisë së ligjit nuk ka pasur të drejtë të aplikojë për këtë pozitë rrjedhimisht nuk ka mund ti cenohet ndonjë e drejtë sa i përket marrëdhënies së punës ngase konkursi nuk ka të bëjë me pozitën që mbanë ankuesja sipas akt emërimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në at që u tha si më lartë ju referua edhe dispozitave të nenit 14 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sa i përket palëve në procedurë administrative në të cilën dispozitë parashihet: "1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët..." 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike" dhe në këtë kuptim të arsyetimit si më lartë me asnjë provë nuk është argumentuar fakti se ankueses i është cenuar interesi juridik në këtë proces për faktin se e njëjta bazuar në legjislacionin në fuqi dhe të specifikuar më lartë nuk ka pasur të drejtë të marrë pjesë në këtë konkurs, dhe në këtë kuptim edhe ankesa është e palejuar në këshill.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1120/2023, datë 22/09/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.